



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 104 Akti**

**Nr. 116 Vendimi**

Tiranë, më 21.03.2019

**V E N D I M**

Trupi gjykues nr. 2, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	Kryesues
<b>Roland Ilia</b>	Anëtar
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, më datë 19.3.2019, ora 10:00, zhvilloi në Pallatin e Kongreseve, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**

**Z. Pashk Gjaci**, gjyqtar, kryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, i pranishëm në seancën dëgjimore.

**OBJEKTI:**

**Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE :**

**Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

## RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Pashk Gjaci është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit të tij si gjyqtar, kryetar në Gjykatën e Shkallës së Parë Përmet. Bazuar në nenin 4, pika 4, dhe në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim, “Komisioni”) ka hedhur shortin, më datë 15.3.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2.
2. Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Inspektorati i Lartë i KLD-së. Subjekti u kontaktua nëpërmjet adresës elektronike të deklaruar për hetim të mëtejshëm, ku i u dërgua edhe pyetësi i përgatitur nga Komisioni.
3. Me vendimin e trupit gjykues, datë 21.3.2018, është vendosur kryesues z. Olsi Komici, si dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.
4. Është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, që do të kryente procesin e rivlerësimit, i cili ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e trupit gjykues.
5. Më datë 22.2.2019, trupi gjykues, vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Pashk Gjaci, bazuar në të tre kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, ta ftojë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.
6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime dhe prova lidhur me barrën e provës dhe rezultatet e hetimit të Komisionit. Provat e paraqitura nga subjekti u pranuan nga trupi gjykues. Trupi gjykues refuzoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për thirrjen e tre dëshmitarëve mbështetur në germën “a”, dhe “b” të pikës 6 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, pasi i çmon si të panevojshme këto dëshmi, për sa kohë ekzistojnë deklarata noteriale të paraqitura nga subjekti dhe të pranuar nga Komisioni, si dhe faktet të cilat rezultojnë të provuara nga dokumentacioni i dosjes lidhur me procedimin penal të vitit 2011; po ashtu njoftoi edhe subjektin e rivlerësimit.
7. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit, z. Pashk Gjaci në seancë dëgjimore, më datë 19.3.2019, ora 10:00 paradite, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë.

## SEANCA DËGJIMORE

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 19.3.2019, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh.
9. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë. Ai paraqiti shpjegime lidhur me barrën e provës dhe rezultatet e hetimit, si dhe iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
10. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe për rrjedhojë edhe procesin e rivlerësimit për z. Pashk Gjaci në seancën e datës 21.3.2019, në të cilën subjekti ishte i pranishëm.

## **PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr.84/2016. Anëtarët e Komisionit *hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit*. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

12. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) Dokumente të tjera shpresore, përveç atyre që ka administruar DSIK-ja;
- ç) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga Inspektoriati i Lartë i KLD- së, së bashku me materialin shoqërues;
- d) Dokumente shpresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- dh) Deklarimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- e) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si dhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht si dhe shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore.
- ë) Denoncimet nga publiku.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

13. Subjekti i deklaramit, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33<sup>1</sup> të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

14. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33/5/a të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konkluduar se:

- a) *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *Ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *Ka kryer deklaram të rremë;*
- e) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

15. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017

---

<sup>1</sup> *Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaramet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe “Kodin e Procedurave Administrative”.*

dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.<sup>2</sup>

16. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Pashk Gjaci, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

17. Në përfundim të hetimit administrativ, kur Komisioni krijoi bindjen se provat kanë nivelin e provueshmërisë, vendosi t'i japë të drejtë subjektit të njihet me rezultatet e këtij hetimi, si dhe me të gjithë dokumentacionin e administruar në dosje.

18. Subjektit iu vunë në dispozicion rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni dhe iu kalua barra e provës në lidhje me pasuritë e deklaruara prej tij në deklaratën "Vetting", si më poshtë:

19. **Ndërtesë me sipërfaqe 21 m<sup>2</sup> në \*\*\*, Mirditë**, privatizuar në vitin 1995, e rivlerësuar në vitin 2011. Vlera e kësaj pasurie është deklaruar 2.800 lekë në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2010, po ashtu edhe në deklaratën "Vetting", dhe nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie.

20. Kjo pasuri rezultoi e blerë bazuar në kontratën e shitblerjes, më datë 24.8.1995, me Ndërmarrjen e Riparim-Shërbimit, Rrëshen. Vlera totale rezulton 12,801 lekë, rivlerësuar më datë 2.9.2011, në vlerën 871,073 lekë.

21. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se ky është një lapsus në deklarim dhe se burimi kanë qenë të ardhurat nga puna e tij.

22. **Ndërtesë me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup> mbi një truall 320 m<sup>2</sup> në \*\*\*, Mirditë**, e privatizuar në vitin 1995, me vlerë fillestare prej 163.188 lekësh, e rivlerësuar në shtator të vitit 2011, në vlerën 9.024.672 lekë.

23. Nga hetimi rezultoi se nuk përputhej deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ZVRPP-së Mirditë, pasi pasuria ndodhet në fshatin \*\*\*, e jo \*\*\*. Gjithashtu, nuk është deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2010, po ashtu as në deklaratën "Vetting" burimi i financimit për këtë pasuri.

24. Subjekti rivlerësimit ka shpjeguar se \*\*\* ka qenë komuna brenda të cilit ishte fshati \*\*\*. Gjithashtu, ai ka shpjeguar se kjo pasuri është blerë pjesërisht me letra me vlerë dhe pjesërisht me kursimet nga puna si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Kurbin asaj kohe.

25. **Tokë arë në bashkëpronësi familjare, me sipërfaqe 2.406 m<sup>2</sup>, në lagjen nr. \*\*\*, Laç**, e ndarë sipas akteve të regjistrimit nga pasuria "mëmë" me sipërfaqe 4.812 m<sup>2</sup>, në vitin 2011. Vlera totale 1.717.882 lekë, pjesa e kontributit të subjekti i rivlerësimit është në vlerën 858.942 lekë. Burimi: nga të ardhurat e siguruar nga puna si avokat në vitin 2009.

26. Për këtë pasuri është lëshuar dhe certifikata për vërtetim pronësie më datë 22.9.2009, në emër të bashkëpronarëve N.Gj. dhe subjektit të rivlerësimit. Është kërkuar pjesëtim pasurie dhe

---

<sup>2</sup>Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, "41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: "Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit". Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi."

është lëshuar më pas dhe certifikata për vërtetim pronësie në emër të subjektit për pasurinë nr. \*\*\*, më datë 5.9.2011, me sipërfaqe 2406 m<sup>2</sup> tokë arë.

27. Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit lidhur me mundësitë financiare të babait për blerjen e pasurisë në bashkëpronësi me subjektin.

28. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se babai i tij është pensionist dhe të ardhurat i ka siguruar nga puna e tij e dytë private, si dhe të ardhura të dërgura nga djali i tij emigrant që prej vitit 1996.

29. Trupi gjykues vlerësoi se kjo pasuri e subjektit të rivlerësimit ishte vënë gjatë kohës që ai ka qenë avokat dhe se prona në bashkëpronësi është ndarë rregullisht sipas ligjit, duke mos e konsideruar, në këtë rast, babain e subjektit, si person tjetër të lidhur.

→ **Trupi gjykues pranoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me tri pasuritë e sipërpërmenduar, duke i vlerësuar ato bindëse.**

**30. Tokë arë me sipërfaqe 3.800 m<sup>2</sup> në fshatin \*\*\*, Velipojë, Shkodër, blerë sipas deklaratës noteriale, datë 17.12.2010, dhe me kontratën e shitblerjes, datë 29.8.2014 (me akt noterial). Vlera totale 1.400.000 lekë. Kjo pasuri është deklaruar që në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2010, kur ishte ende e paregjistruar.**

31. Për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesat, datë 12.1.2016, drejtuar ZVRPP-së Shkodër si dhe, datë 2.3.2016, drejtuar Ministrit të Drejtësisë, ku është kërkuar vënia në lëvizje e ZVRPP-së Shkodër për ndarjen e kësaj pasurie me qëllim kalimin nëpërmjet dhurimit të një pjese të saj babait dhe vëllait, në këmbim të kontribut të tyre për shtëpinë e banimit 3-katëshe në qytetin e Laçit, e cila trajtohet më poshtë në këtë vendim.

32. Nga hetimi rezultoi se nuk përputhen veprimet e kryera nga subjekti dhe deklaratimet përkatëse ndër vite, me deklaratimet në formularin “Vetting”.

33. Në kuptim të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe për këtë subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

34. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

35. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se janë bërë disa akte noteriale, aktmarrëveshje me nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë 2.1.2012, deklaratë noteriale me nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë 10.8.2015, kontratë dhurimi me nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë 8.9.2017, dhurim dhe deklaratë noteriale, lidhur me pasqyrimin e kësaj situate, duke i paraqitur ato.

36. Nga dokumentacioni vërehet se në janar të vitit 2017 është realizuar ndarja e tokës në dy pjesë prej 3.800 m<sup>2</sup> në fshatin \*\*\*, me nga 1.900 m<sup>2</sup>, por nuk rezultoi se pjesa prej 1.900 m<sup>2</sup> të ketë kaluar në pronësi të vëllait. Ajo figuron ende e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion ligjor provues që të bindte trupin gjykues për shkaqet e mosregjistrimit të kësaj prone deri në plotësimin e deklaratës “Vetting”.

37. Subjekti i rivlerësimit:

- ka paraqitur në deklaratën “Vetting” këtë pronë, 100% në pronësi të tij, megjithë pretendimin se e ka shkëmbyer këtë pronë që në vitin 2012 me vëllain dhe babain e tij, mbështetur në aktmarrëveshjen nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.;
- nuk ka pasqyruar ndryshime të kësaj prone, në deklaratat periodike vjetore;
- nuk ka deklaruar asnjëherë posedimin e pjesës prej 1.900 m<sup>2</sup> nga vëllai i tij.

38. Trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë këtë pasuri në deklaratën “Vetting”. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, deklaratimet periodike vjetore dhe dokumentet e paraqitura, nuk pasqyrojnë saktësi dhe besueshmëri të deklaratimeve të bëra në formularin vetting.

**39. Shtëpi banimi 3-katëshe**, në lagjen nr. \*\*\*, Laç, **me sipërfaqe ndërtimi të katit të parë 191 m<sup>2</sup> dhe truall 500 m<sup>2</sup>**, ndërtuar me lejen e ndërtimit të vitit 2002, në emër të Pashk Gjaci. Pasuria është regjistruar në ZVRPP në vitin 2011, 100% në emër të subjektit të rivlerësimit.

40. Vlera e deklaruar e kësaj pasurie, nga subjekti i rivlerësimit, në momentin e regjistrimit është 11,500,000 lekë, mbështetur në aktin e kolaudimit dhe situacionet për këtë objekt. Kjo pasuri është rivlerësuar në vitin 2012 me vlerë 25,260,931 lekë.

41. Subjekti i rivlerësimit është pajisur me leje sheshi dhe leje ndërtimi në nëntor të vitit 2002, për ndërtimin e një shtëpie banimi 3-katëshe me sipërfaqe ndërtimi 191 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe truall 500 m<sup>2</sup>. Këtij veprimi i ka paraprirë një aktmarrëveshje e nëntorit të vitit 2002, ku babai i subjektit e lejon atë të ndërtojë mbi truallin që i është dhënë nga shteti, duke u pajisur edhe me leje sheshi dhe ndërtimi në emrin e tij. Babai i subjektit deklaroi se, në momentin që ai do të bëhej pronar i ligjshëm i truallit, do t'ia kalonte në pronësi djalit të tij, Pashk Gjaci.

42. Nga dokumentacioni rezultoi se në vitin 2003, babai i subjektit të rivlerësimit ka blerë tokën në Bashkinë Laç, në vlerën prej 190,000 lekësh, pavarësisht faktit se leja e ndërtimit i ishte dhënë shtetasit Pashk Gjaci (subjektit të rivlerësimit).

43. Të gjitha veprimet e kryera për ndërtimin deri në regjistrimin e pronës, rezultojnë të jenë kryer nga subjekti i rivlerësimit, si pronar i vetëm i kësaj pasurie dhe në emrin e tij.

44. Nuk ka një akt ligjor që vërteton kalimin e pronësisë së truallit nga babai në emër të subjektit, megjithëse ajo rezultoi e regjistruar në vitin 2011 në emër të subjektit të rivlerësimit (truall + ndërtesë).

45. Në deklaratimin “Vetting” subjekti deklaroi shtëpi banimi 3-katëshe, me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup> e truall 500 m<sup>2</sup>, 100% pronar. Në deklaratën para fillimit të detyrës, të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit deklaroi këtë pasuri si 33% bashkëpronar (ende e parregjistruar në atë kohë në ZVRPP).

46. Burimi për ndërtimin e kësaj prone, vilë 3-katëshe, është deklaruar në deklaratimin “Vetting” si dhe deklaratën para fillimit të detyrës, me kontribut të përbashkët të: subjektit të rivlerësimit, babait dhe vëllait të tij.

47. Personat e tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, babai dhe vëllai, të cilët janë deklaruar se kanë qenë bashkëinvestues në këtë banesë, nuk rezultojnë në asnjë nga veprimet e kryera, që nga marrja e lejes së ndërtimit, akti i kolaudimit të ndërtesës e deri tek regjistrimi i objektit në hipotekë.

48. Sipërfaqja e objektit ndërtimor, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit prej 140 m<sup>2</sup>, sipas të gjithë dokumentacionit të ndodhur në dosje dhe vërtetimit të ZVRPP-së Kurbin, rezultoi 191 m<sup>2</sup>.

49. Për të njëjtin shesh ndërtimi, nga Bashkia Laç në vitin 1997, i është dhënë leje sheshi dhe leje ndërtimi babait të subjektit të rivlerësimit për një objekt me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>.

50. Nga hetimi rezultoi se, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë këtë pasuri në formularin “Vetting” dhe se ajo nuk përputhet me deklaratimin e bërë nga subjekti i rivlerësimit për herë të parë në vitin 2010, as deklaratimet ndër vite nuk kanë pasqyruar ndryshime të kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit nuk ka patur burime të ligjshme financiare, të mjaftueshme, për ndërtimin e kësaj pasurie.

51. Në kuptim të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

52. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

53. Subjekti rivlerësimit paraqiti shpjegimet e tij ku tregonte se babai ishte pajisur me leje sheshi dhe leje ndërtimi për një shtëpi banimi në vitin 1997, në një tokë të cilën babai e kishte blerë herët nga ish-pronari, i cili nuk dispononte dokumentacion ligjor.

54. Për të njëjtin shesh ndërtimi, subjekti i rivlerësimit është pajisur me leje sheshi dhe leje ndërtimi në nëntor të vitit 2002 për një objekt me sipërfaqe 191 m<sup>2</sup>.

55. Subjekti rivlerësimit ka deklaruar se shtëpia është ndërtuar gjatë periudhës që ai ka ushtruar profesionin e avokatit. Ajo është ndërtuar nga ai dhe i vëllai me kontribute të përbashkëta, dhe se babai i tyre ka kontribuar me blerjen e tokës me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup>. Në janar të vitit 2012 ata kanë lidhur aktmarrëveshjen nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., para noterit, ku vëllai dhe babai i subjektit të rivlerësimit deklarojnë se me kontributin e përbashkët të secilit, me 1/3 pjesë, është ndërtuar një shtëpi banimi 3-katëshe me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup> në qytetin e Laçit (\*\*\*), ku z. N. Gj. ka qenë pronar i truallit dhe dy djemtë kanë kontribuar me pjesë të barabarta për ndërtimin e banesës. Babai i subjektit të rivlerësimit dhe vëllai Gj., deklarojnë se këmbejnë pjesën e tyre në këtë pronë, përkatësisht me sipërfaqe toke në fshatin \*\*\* të komunës Velipojë (e trajtuar më sipër në këtë vendim), pasuri e blerë me kontributin e subjektit të rivlerësimit.

56. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti ndonjë dokumentacion ligjor për të provuar lidhur me mundësitë financiare të babait apo vëllait të tij Gj., për ndërtimin e shtëpisë.

57. Lidhur me vlerën e shtëpisë, për të cilën komisioni i është referuar aktit të kolaudimit të objektit dhe situacioneve të deklaruara nga vetë subjekti i rivlerësimit, ai shpjegoi se një pjesë e kontributeve kanë qenë edhe në natyrë me punë fizike nga vetë ata të tre.

58. Lidhur me sipërfaqen e ndërtimit të deklaruar prej 140 m<sup>2</sup> dhe jo 191 m<sup>2</sup>, ai shpjegoi se i është referuar sipërfaqes së ndërtimit bazuar në lejen e parë të marrë në vitin 1996 nga babai i tij. Subjekti sqaroi se, ai e ka ndërtuar këtë shtëpi mbi shtëpinë ekzistuese karabina të ndërtuar më parë nga babai i tij. Për arsye të humbjes së dokumentacionit përkatës në bashki në vitin 1997, ata kanë qenë të deyruar ta rimarin lejen e ndërtimit nga fillimi.

59. Në përfundim, trupit gjykues arrin në përfundimin se:

1. Në përllogaritjen e burimit të ligjshëm financiar të subjektit të rivlerësimit, në mungesë të dokumenteve provuese lidhur me pagesat e kryera, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave nga vëllai, Komisioni duhet t'i referohet të dhënave të aktit të kolaudimit dhe akteve provuese të mbledhura gjatë hetimit.

2. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, të paprovuara me dokumentacion ligjor, nuk mund të çlirojnë subjektin e rivlerësimit nga detyrimi për të provuar mundësitë financiare të bashkëpronarëve në këtë pronë si dhe të kundërshtojë aktin e kolaudimit dhe dokumentacionin tjetër ligjor provues mbi vlerën e objektit si dhe pronësinë mbi këtë pasuri. Trupi gjykues vlerësoi se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk vijnë në harmoni me dokumentacion ligjor që disponohet në dosje.

3. Deklarimi në formularin “Vetting” i pasurisë shtëpi banimi 3-katëshe, 100% në pronësi të subjektit të rivlerësimit, nuk përputhet me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2010, ku kjo pronë është deklaruar 33% në bashkëpronësi me vëllain dhe babain si dhe deklaratimet periodike ndër vite.

4. Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka regjistruar këtë pronë në vitin 2011 në ZVRPP, 100% në pronësi të tij. Ai nuk ka deklaruar në deklarin periodik vjetor të vitit 2011

ndryshime në pjesët takuese të kësaj prone. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as në deklarimin periodik vjetor të vitit 2012 ndryshime në pjesët takuese të pronës, mbështetur në aktmarrëveshjen e vitit 2012 për shkëmbimin e pjesës së shtëpisë me sipërfaqen e truallit tokë arë, në fshatin \*\*\* të komunës Velipojë.

5. Subjekti i rivlerësimit nuk mund të justifikonte me burime të ligjshme financiare ndërtimin e kësaj pasurie në masën 100% të saj, prej tij. Ai nuk paraqiti dokumentacion ligjor për të provuar mundësitë financiare të të vëllait dhe babait të tij, për ndërtimin e kësaj shtëpie.

6. Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se, subjekti i rivlerësimit ka blerë në formën ligjore pronën prej 3.800 m<sup>2</sup> tokë arë në fshatin \*\*\* të komunës Velipojë në vitin 2014 dhe e ka regjistruar 100% në pronësi të tij, megjithëse ai pretendon se sipërfaqen prej 1.900 m<sup>2</sup> e kishte këmbyer me vëllain dhe babain, përkatësisht me pjesën takuese të tyre në shtëpinë e banimit 3-katëshe në lagjen nr. \*\*\*, Laç.

7. Kontrata e dhurimit për sipërfaqen e truallit mes subjektit të rivlerësimit, vëllait dhe babait të tyre është realizuar në shtator të viti 2017 pas plotësimit të deklaratës “Vetting” dhe këtë deklaratë prona tokë arë në fshatin \*\*\* të komunës Velipojë është deklaruar në emër të subjektit të rivlerësimit, në masën 100%.

8. Referuar vlerës së pasurive, të cilat janë këmbyer, Komisioni nuk i gjen ato në raport të drejtë dhe të përafërt. Bazuar në kontratën e shitblerjes, të datës 29 gusht 2014, subjekti i rivlerësimit ka blerë pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3,800 m<sup>2</sup> në vlerën prej 1,400,000 lekësh. Bazuar në deklaratimet e subjektit si dhe dokumentacion e administruar në dosje, vlera e ndërtimit të shtëpisë, vilë tre kate, në Laç është 11,500,000 lekë, pasuri e cila është rivlerësuar në vitin 2012 në vlerën 25,260,931 lekë.

9. Subjekti nuk arriti të bind trupin gjykues lidhur me arsyet e deklaratimit të sipërfaqes së shtëpisë në 140 m<sup>2</sup> kur ajo në fakt është 191 m<sup>2</sup> si në lejen e ndërtimit ashtu edhe në dokumentin e regjistrimit të pronës në ZVRPP.

10. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016 si dhe në referim të vendimeve të KPA-së, deklaratimet periodike duhet të merren në konsideratë si provë, pasi ato mund të hedhin dritë mbi burimet e krijimit të pasurisë dhe mbi ligjshmërinë e saj. Nga vlerësimi i deklaratimeve periodike rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë transksionet dhe veprimet ligjore të kryera me pronën e tij.

11. Trupi gjykues, vlerëson se deklaratimet e subjektit në deklaratën “Vetting” dhe shpjegimet e dhëna pas saj nuk ishin të sakta dhe të besueshme krahasuar edhe me deklaratimet periodike vjetore të bëra nga subjekti i rivlerësimit.

12. Subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provoi bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, e cila rezultoi të jetë krijuar para se subjekti të bëhet gjyqtar. Kjo pasuri iu nënshtrua vlerësimit nga komisioni pasi ishte pjesë e deklaratimeve të subjektit në formularin “Vetting”. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në formularin “Vetting” dhe deklaratimet periodike vjetore lidhur me këtë pronë, rezultuan të pasakta.

13. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar në mënyrë të saktë pasuritë në pronësi posedim apo përdorim të tij dhe personave të tjerë të lidhur, ai ka fshehur sipërfaqen reale të ndërtesës shtëpi banimi 3-katëshe. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk provuan saktësinë dhe besueshmërinë e deklaratës “Vetting”.

60. **Automjeti i markës “Isuzu, Autokarro”** blerë në vitin 2008. Burimi: nga i vëllai, si dhe nga kursimet familjare ku përfshihen vlera e zhdoganimit dhe e regjistrimit. Vlera e mjetit është 350.000 lekë dhe zotërimi 100%.

→ Përputhen deklaratimet e subjektit me shpjegimet e dhëna prej tij dhe dokumentacionin e administruar në dosjen e Komisionit.



61. **Letra me vlerë dhuruar nga nëna**, të përfituara si ish e përndjekur politike dhe të depozituara sipas kontratës së shitjes, datë 13.1.1997, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k, e cila aktualisht është në proces gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që nga viti 2000. Vlera e tyre është 249.201 lekë, të pakthyera deri më sot. Zotërimi nga subjekti: 100%.

→ Përputhen deklaratimet e subjektit me shpjegimet e dhëna prej tij dhe dokumentacionin e administruar në dosjen e Komisionit.

62. **Tokë arë dhe truall, me sipërfaqe 3.100 m<sup>2</sup> në fshatin \*\*\*, Mirditë**. Burimi i trashëguar, dokumentuar me ATMP-në, datë 30.5.1992. Aktualisht e përgjithshme për gabime kufizimesh në ZVRPP-në Mirditë. Zotëron 100% të pronës.

→ Përputhen deklaratimet e subjektit me shpjegimet e dhëna prej tij dhe dokumentacionin e administruar në dosjen e Komisionit.

63. **Autovetorë e tipit “Mercedes Benz \*\*\*\*”**, e importuar sipas deklaratës doganore, më datë 28.1.2011. Burimi nga të ardhurat nga puna si avokat si edhe nga kursimet familjare. Vlera totale është 692.516 lekë dhe zotërimi 100% mbi mjetin.

→ Përputhen deklaratimet e subjektit me shpjegimet e dhëna prej tij dhe dokumentacionin e administruar në dosjen e Komisionit.

64. **Depozitë bankare në “Raiffeisen Bank” në vlerën 3.500.000 lekë**, minus tërheqjet. Burimi nga shitja e apartamentit 2+1 në Laç me kontratën, datë 18.5.2015.

→ Përputhen deklaratimet e subjektit me shpjegimet e dhëna prej tij dhe dokumentacionin e administruar në dosjen e Komisionit.

65. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” deklaroi të **ardhura nga avokatia për periudhën 2000 - 2010 para fillimit të detyrës, në vlerën 16.000.000 lekë**. Po ashtu, në deklaratën para fillimit të detyrës (viti 2010) ai deklaroi të njëjtën vlerë, duke iu referuar vlerës së qarkullimit vjetor.

66. Mbështetur në dokumentacionin që Komisioni administroi nga organet tatimore dhe zyra e taksave vendore Kurbin, rezultoi se qarkullimi total vjetor për periudhën 2000-2010 për subjektin i rivlerësimit është në masën 13.800.000 lekë.

67. Në analizën ekonomike të kryer, Komisioni iu referua marzhit të fitimit për këtë aktivitet në masën 60% të qarkullimit vjetor për vitet 2000-2008 dhe fitimit neto të qarkullimit për vitin 2009 sipas dokumentit të ardhur nga zyra e tatimeve Kurbin. Sipas dokumentacionit të administruar në Komision, qarkullimi vjetor i deklaruar për vitin 2010 ka qenë 0 (zero).

68. Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës të paraqesë dokumentacion ligjor provues lidhur me vlerën totale prej 16.000.000 lekësh të qarkullimit të pretenduar/deklaruar nga ai, si dhe të japë shpjegime të arsyeshme dhe bindëse lidhur me masën e fitimit neto të realizuar nga ky aktivitet.

69. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se, xhiro është ajo e deklaruar nga ai në deklaratën “Vetting” si dhe deklarimin periodik vjetor të vitit 2010, por ai nuk paraqiti ndonjë dokumentacion ligjor provues nga autoritetet përkatëse mbi shumën e pretenduar.

70. Lidhur me marzhin e fitimit, subjekti ka dhënë sqarime të përgjithshme mbi përllogaritjen e tij duke pretenduar se ai duhet të llogaritet në masën 90% të vlerës së qarkullimit vjetor, pasi një zyrë avokatie nuk ka shpenzime të tjera.

71. Trupi gjykues vlerësoi se vlera e deklaruar e qarkullimit për të cilat janë paguar edhe detyrimet tatimore për periudhën 2000-2010, është në total në masën 13.800.000 lekë, mbështetur në dokumentacionin e administruar nga organet kompetente. Subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion ligjor për të provuar se kish përfituar të ardhurat e pretenduara.

72. Lidhur me përlogaritjen e marzhit të fitimit neto, të subjektit të rivlerësimit, nga puna e tij si avokat, nisur nga fakti se nuk ka një dokument zyrtar që konfirmon marzhin e fitimit nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të subjektit për atë periudhë, trupi gjykues, pasi shqyrtoi edhe përgjigjet e marra nga organi kompetent tatimor, gjykon të arsyeshme që ky marzh të mund të llogaritet në masën 80% të vlerës së qarkullimit vjetor, pasi nga ai duhet të zbriten tatimet dhe taksat e paguara, detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore si dhe shpenzime për ushtrimin e aktivitetit si qira, shërbimet utilitare e shpenzime të tjera të nevojshme.

Të ardhura nga avokata Pashk Gjaci	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	TOTAL
Qarkullimi i konfirmuar nga Tatimet	1.000.000	1.000.000	1.200.000	1.300.000	1.000.000	1.000.000	1.000.000	1.500.000	3.100.000	1.700.000	-	13.800.000
Koeficienti i aplikuar	80%	80%	80%	80%	80%	80%	80%	80%	80%	16%	0%	
Fitimi përlogaritur	800.000	800.000	960.000	1.040.000	800.000	800.000	800.000	1.200.000	2.480.000	270.000	0	9.950.000

73. Nga analiza financiare, rezultoi se pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2010, nuk përballoheshin me të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit, pasi ato nuk ishin të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve për ndërtimin e shtëpisë 3-katëshe në Laç.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë.**

Trupi gjykues, arrin në përfundimin se:

*I. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë. Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë në pronësi apo posedim të tij dhe personave të tjerë të lidhur, në formularin “Vetting” si dhe deklarimet periodike vjetore, duke bërë deklaram të rremë.*

*II. Subjekti nuk justifikoi me burime të ligjshme financiare pasuritë në pronësi të tij nga ku rezultoi se ai ka pasuri më të madhe nga ajo që mund të justifikohet ligjërisht, por pasuria e tij nuk kalon dyfishin e pasurisë së ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe se ajo është krijuar gjatë periudhës së ushtrimit të profesionit të avokatisë.*

### **B. VLERËSIMI I FIGURËS**

74. DSIK-ja ka paraqitur pranë KPK-së raportin përfundimtar lidhur me subjektin e rivlerësimit, Pashk Gjaci, i cili është deklasifikuar plotësisht, ku rezulton se:

*- Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës.*

*- Për subjektin e rivlerësimit është regjistruar një procedim penal për veprën penale “\*\*\*”. Pas kryerjes së hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë ka vendosur, më datë 13.3.2015, pushimin e hetimeve.*

*Parë nga këndvështrimi i përgjithshëm i kontrollit apo pastërtisë së figurës, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerjen ose moskryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin, në mospërmbushje të rregullt të detyrës, dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale, të padrejta për vetë si funksionar publik apo personat e lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit, apo personave të tjerë, cenojnë figurën e tij, integritetin, shkallën e besueshmërisë dhe e bëjnë këtë individ të mundshëm për t'u vënë nën presion nga strukturat kriminale, sipas përcaktimeve të germës c të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016.*

***Për sa më sipër, grupi i punës në DSIK konstaton papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit, Pashk N. Gjaci.***

75. Subjektit të rivlerësimit iu kërkua të paraqesë shpjegime lidhur me konstatimet e arritura nga grupi i punës i DSIK-së.

76. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegimet e tij lidhur me procedimin penal të nisur ndaj tij për veprën penale “\*\*\*\*” ku sqaron se, procedimi penal i nisur ndaj tij është pushuar nga organi kompetent me arsyetimin se, fakti penal nuk ekziston duke bërë arsyetim të posaçëm se çfarë veprimesh kanë qenë ato të subjektit të rivlerësimit, në çështjen në fjalë. Qytetari ankues ka paraqitur ankesë edhe tek institucionet shtetërore si, KLD, Ministria e Drejtësisë, etj., lidhur me këtë çështje gjyqësore.

77. Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2015 drejtuar KLD-së, mbështetur në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. \*\*\* datë 27.2.2014, vlerëson se nuk ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore për vazhdimin e procedimit disiplinor të iniciuar me kërkesë të tij, ndaj gjyqtarit Pashk Gjaci, prandaj duhet të ndërpritet procedimi disiplinor. KLD-ja, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.12.2015, ka vendosur ndërprerjen e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit Pashk Gjaci.

78. Komisioni, me kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 20.11.2018, i ka kërkuar informacion Prokurorisë së Përgjithshme lidhur me procedimet e mundshme dhe të dhëna për subjektin e rivlerësimit Pashk Gjaci. Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar informacionin që disponon, sipas të cilit rezultoi se ndaj subjektit të rivlerësimit është filluar një procedim penal në vitin 2014, për veprën penale të \*\*\*, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, dhe më pas është ndjekur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Hetimet kanë filluar pas kërkesës së bërë nga shtetasi S.R. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, më datë 13.3.2015, është vendosur pushimi i hetimit.

79. Më datë 16.1.2016, Pashk Gjaci është emëruar për herë të dytë në detyrën e kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.

***→ Në përfundim, trupi gjyqësor vlerësoi se konkluzionet e arritura nga grupi i punës i DSIK-së nuk janë të mbështetura në prova dhe në ligj, dhe se ato nuk qëndrojnë.***

80. Bazuar në indicie të marra nga organet ligjzbatuese, Komisioni zhvilloi një procedurë hetimore lidhur me një vendim gjyqësor, të ndjekur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, si dhe transparencën e ndjekur ndaj kësaj çështjeje në të gjitha hapat.

81. Nga kërkimet, rezultoi se vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 16.3.2018, me palë të pandehur P.B., nuk figuronte i publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, por ai u gjet në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, e cila kishte trajtuar çështjen në shkallën e dytë të gjyqimit.

82. Komisioni i kërkoi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, një kopje të praktikës lidhur me vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 16.3.2018, me palë të pandehur shtetasin P.B., si dhe informacion lidhur me mospublikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, me shkresën nr. \*\*\* dërgoi informacionin lidhur me praktikën e ndjekur si dhe kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 7.12.2017.

83. Sipas kësaj dosjeje, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështjen me palë kërkuese Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, dhe palë të pandehur shtetasin P.B., për kryerjen e veprës penale “\*\*\*\*”. Në përfundim, më datë 7.12.2017, është dhënë vendimi për pranimin e kërkesës së Prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq kundër të pandehurit P. B., në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet. Në këtë vendim rezultoi se janë trajtuar kërkesat sipas objektit të çështjes dhe është dhënë vendimi bazuar në kërkesat e bëra.

84. Në dosjen e dërguar rezulton se çështja e shqyrtimit në themel ndaj të pandehurit është bërë nga një trup gjykues, caktuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Fillimisht, gjyqtarja e caktuar me short për shqyrtimin e kësaj çështjeje ka deklaruar moskompetencën dhe ka hequr dorë nga shqyrtimi i çështjes, kërkesë e cila është pranuar nga kryetari i gjykatës. Më pas, është hedhur shorti për caktimin e trupit gjykues për këtë çështje ku janë caktuar gjyqtarët Pashk Gjaci, D.H. dhe Y.Sh.

85. KLD-ja, me shkresën nr. \*\*\*, datë 26.1.2018, bazuar në kërkesën e Gjykatës së Përmetit për shkak të mungesës së formimit të trupit gjykues nga kjo gjykatë, ka caktuar trupin gjykues me tre gjyqtarë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, megjithëse është kërkuar zëvendësimi vetëm i një anëtari të trupit gjykues.

86. Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit mbi arsyet e zëvendësimit të të gjithë anëtarëve të trupit gjykues si dhe të vetë subjektit të rivlerësimit në këtë çështje. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me arsyet e mospublikimit të këtij vendimi dhe praktikës së ndjekur për këtë çështje, në faqen e internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

87. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se zëvendësimi është bërë nga KLD-ja për të gjithë trupën. Ai ka qenë gjyqtari që është caktuar për vlerësimin paraprak të çështjes për të pandehurin, prandaj dhe është vlerësuar se nuk mund ta gjykonte këtë çështje edhe në themel.

88. Lidhur me mospublikimin e vendimit dhe të gjithë praktikës, në faqen e *web-it*, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se kjo lidhet me mirëmbajtjen e sistemit elektronik, i cili bëhet nga kompania kontraktore \*\*\*, që ka kufizuar edhe çështje të tjera dhe se ajo nuk varej nga gjykatat, por se duhet kërkuar informacion në Ministrinë e Drejtësisë.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë.**

*Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacione nga organet ligjzbatuese, si dhe zhvilloi një hetim të thelluar kryesisht, bazuar në parimin e transparencës, procesit të rregullt ligjor, barazisë së palëve në procesin gjyqësor, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të figurës, arrin në përfundimin se:*

I. *Veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë proces janë të drejta, deklarimet e tij përputhen me dokumentacionin e administruar në dosje. Nga vlerësimi në tërësi i dokumentacionit në dosje si dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues krijoi bindjen se nuk ka patur shkelje ligjore si dhe të dhëna të mjaftueshme që mund të cenojnë figurën e gjyqtarit.*

II. *Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që ai të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë gjen të pambështetur konkluzinin e grupit të punës së DSIK-së për subjektin e rivlerësimit Pashk Gjaci.*

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

90. Këshilli i Lartë i Drejtësisë paraqiti një raport për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

91. Komisioni nga vlerësimi për tri dosjet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit si dhe pesë dosjet e përzgjedhura me short, nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

92. Në pesë dosjet e përzgjedhura me short janë konstatuar disa mangësi procedurale lidhur kryesisht me respektimin e afateve procedurale.

93. Subjekti ka sqaruar se, me vënien në punë të sistemit elektronik, Gjykata e Përmetit ka ndjekur transparencë të plotë, por se disa çështje gjyqësore të zgjedhura me short nuk i përkasin asaj periudhe. Për arsye të organizimit kanë ndodhur edhe disa vonesa.

94. Në tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara të zgjedhura me short, rezulton se janë ankimuar tri dokumentet ligjore dhe një dosje e vëzhguar. Në të katër rastet, gjykatat më të larta kanë vendosur lënien në fuqi të vendimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit (*shih* dokumentet 1, 2, 3 dhe dosjen 5). Ndërsa për katër dosjet e tjera të vëzhguara nuk rezulton të jetë bërë ankim ndaj vendimit të dhënë prej gjyqtarit.

95. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës 3-vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Pashk Gjaci janë paraqitur gjithsej 7 ankesa në Inspektoratin e KLD-së, të cilat janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar.

96. Në përfundim, nga vlerësimi i tri dosjeve të zgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dokumenteve ligjore të përzgjedhur me short për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit, Pashk Gjaci, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, janë të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe në shumicën e rasteve përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme dhe e standardizuar. Ai, përgjithësisht, i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, ku pasqyrohet edhe shkaku ligjor.

97. Aftësitë e tij organizative janë bërë edhe objekt ankesash. Konkretisht, Inspektorati ka verifikuar dy ankesa qytetarësh, që ngrinin pretendime për mosrespektim formal të ligjit dhe për zvarritje në gjykim. Në një rast, ankesa i është regjistruar për vlerësim profesional dhe etik për zvarritje, ndërsa në një rast tjetër për mosrespektim formal të ligjit. Materialet e ankesës i janë përcjellë Ministrisë së Drejtësisë për procedimin disiplinor, por procedimi disiplinor është ndërprerë gjatë shqyrtimit në mbledhje të KLD-së me kërkesë nga vetë Ministri i Drejtësisë.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional**

*I. Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, dhe konsiderohet “i aftë”.*

*II. Trupi gjykues arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.*

## **DENONCIMET NGA PUBLIKU**

**98. Nga informacioni i ardhur nga publiku**, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, z. Pashk Gjaci, është paraqitur **ankesa e shtetasit S.R.** e cila ka objekt kundërshtimin e vendimit gjyqësor nr. \*\*\* datë 11.6.2013 të subjektit të rivlerësimit. Për këtë objekt, ankesa i është drejtuar edhe KLD-së, e cila me shkresën e datës 17.4.2014, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, për vlerësim dhe gjykim të mundësisë eventuale të inicimit të procedimit penal disiplinor të subjektit të rivlerësimit.

99. Sipas raportit të Inspektorëve të Inspektoriatit të KLD-së rezulton se, subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. \*\*\*, datë 25.11.2013. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.1.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\* për shkelje të normave procedurale-civile, për thirrjen e palëve në gjykim duke mos respektuar parimin e kontradiktoritetit dhe duke cenuar për pasojë të drejtën e pronësisë së palës si dhe cenimin e paanësisë në gjykim, mëqenëse çështja është gjykuar nga i njëjti gjyqtar që ka shqyrtuar çështjen e themelit.

100. Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. \*\*\* prot., **datë 30.10.2015**, drejtuar KLD-së, mbështetur në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. \*\*\*, datë 27.2.2014, vlerëson se nuk ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore për vazhdimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit Pashk Gjaci, prandaj duhet të ndërpritet procedimi disiplinor. KLD-ja, me vendimin nr. \*\*\*, **datë 22.12.2015** ka vendosur ndërprerjen e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit Pashk Gjaci.

101. Bazuar në disa fakte, mbi denoncimet e publikuara në mediat e shkruara, subjekti i rivlerësimit ishte denoncuar lidhur me përpjekje për marrjen me forcë të një prone nga pronarët e ligjshëm. Konkretisht, në janar të vitit 2011, së bashku me disa persona të tjerë, ai ka ndërhyrë në pronën e shtetasit P.Gj. në zonën e njohur si gryka e lumit në \*\*\* të Lezhës. Për këtë çështje, është bërë kallëzim penal nga shtetasi P.Gj. për subjektin e rivlerësimit dhe babain e tij. Po ashtu, është hapur një procedim penal nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Materialet proceduriale në ngarkim të shtetasve Pashk dhe N.Gj. i kanë kaluar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprën penale “\*\*\*”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal.

102. Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, me shkresën nr. \*\*\*, datë 21.5.2018, janë dërguar të dhënat lidhur me procedimin penal të vitit 2011, që kanë të bëjnë me subjektin Pashk N. Gjaci. Sipas akteve të ndodhura në këtë dosje, çështja dhe procedimi penal ka filluar ndaj shtetasit N.Gj., i cili është babai i subjektit të rivlerësimit. Nuk rezultoi të ketë filluar ndonjë procedim penal ndaj subjektit të rivlerësimit.

**103. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar thirrjen e dëshmitarëve lidhur me këtë çështje, të cilën trupi gjykues e refuzoi mbeshtëtur** në germën “b” të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, si dhe njoftoi edhe subjektin e rivlerësimit pasi e çmon si të panevojshme këtë dëshmi, pasi faktet që kërkohen të provohen rezultojnë të provuara nga dokumentacioni i dosjes lidhur me procedimin penal të vitit 2011.

104. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se prona në fjalë është e blerë nga babai i tij dhe se konflikti me shtetasin P.Gj. ka ndodhur për arsye të mbivendosjes së pronës së blerë prej tij dhe pronës së blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit. Ai ka sqaruar se ka qenë prezent në disa situata konflikti për të mbështetur dhe suportuar ligjërisht të drejtat e babait të tij, por se ai, në asnjë rast nuk ka qenë pjesë e ndonjë përplasjeje më këta shtetas dhe se nuk ka ushtruar asnjë ndikim lidhur me zgjidhjen e kësaj çështjeje, e cila aktualisht është ende e pazgjidhur.

→ *Trupi gjykues vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjektit i rivlerësimit të cilat ishin në përputhje me dokumentacionin e administruar nga organet kompetente dhe në përfundim nuk gjeti indice të cilat të ngrenë dyshime të arsyeshme mbi veprime korruptive të kryera nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpunim me persona të tjerë.*

## KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura nga ai, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, konstaton se, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë për kriterin e pasurisë. Në zbatim të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ai ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij dhe të personave të tjerë të lidhur dhe se me shpjegimet dhe provat e paraqitura ai nuk arriti të bindë trupin gjykues për të kundërtën, duke mos arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Pashk Gjaci, me funksion gjyqtar, kryetar i Gjykatës së Rrethit gjyqësor Përmet.
2. Ky vendim i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 21.3.2019

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**KRYESUES**

**Olsi Komici**

**ANËTAR**

**Roland Ilia**

**RELATOR**

**Valbona Sanxhaktari**

Sekretare gjyqësore

Fiorela Mandro